



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilbena/Prodato Received/Delivered	29. 12. 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHUK	7721/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr 639/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.3035/202, të datës 31.10.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.639/2021, të datës 14.07.2021, të parashtruar nga ankuesi nga Istogu, kundër organit të punësimit: Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “*kërkese nga marrëdhënia punës*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.12.2023, njëzëri mori këtë;

V E N D I M

Refuzohet si papranueshme ankesa me numër A. nr. 639/2021, e datës 14.07.2021, e parashtruar nga ankuesi .

A r s y e t i m

Ankuesi . (tutje ankuesi) i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 14.07.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.639/2021, me pretendimin ankimor që t’i behët nivelizimi i pagës, konkretisht ngritja e koeficientit të pagës nga koeficienti aktual pesë (5), në koeficientin gjashtë (6).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.07.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin

Korrektues të Kosovës. Ndërsa, Këshilli me datë 04.08.2021, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.07.2021 përmes shkresës me numër protokollit 4411/2021, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës me numër A.nr.639/2021 të datës 14.07.2021, duke e udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë gjyqësore në gjykatën kompetent gjegjësisht Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativë, me datë 31.10.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.3035/2021, me të cilin ka aprovuar padinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të datës 26.08.2021, duke e obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit Rifat Jahaj të datës 14.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3699/2021 të datës 14.07.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt-in e Emërimit të datës 05.03.2013 të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit të datës 21.07.2021; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 4076/2021 të datës 04.08.2021; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit lidhur me pozitën e punës Asistent Administrativ; Listën e pagave për periudhën kohore 01.07.2021 deri me 31.07.2021; emali i KPSHCK i datës 24.08.2021, Emalin i datës 25.08.2021 të A. drejtuar I. ; Njoftimin me numër protokollit 4411/2021 të datës 26.08.2021;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit ***është e pa bazuar, sepse:***

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe se i njëjti sipas Aktit të Emërimit të nënshkruar nga ankuesi me datë 07.03.2013, ushtron pozitën e punës Asistent Administrativ, në Qendrën Korrektues në Dubravë.

Ankuesi, më datë 14.07.202, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për harmonizimin e koeficientit të pagës nga pesë (5) në koeficientin gjashtë (6), duke shtuar së i njëjti disa herë kishte paraqitur kërkesë të organi i punësimit për harmonizim të koeficientit të pagës, por se asnjëherë nuk kishte marrë përgjigje nga punëdhënësi lidhur me këto kërkesa.

Për vendosje të drejtë dhe meritore dhe nisur nga fakti se ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se i njëjti ka deponuar disa kërkesa të organi i punësimit për harmonizim të koeficientit të pagës, duke mos ofruar asnjë dëshmi që provon një fakt të tillë, Këshilli me datë 24.08.2021, ka kërkuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Shërbimit Korrektues dorëzimin e kërkesave të ankuesit të parashtruara në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës, ndërsa kjo e fundit me datë 25.08.2021, ka njoftuar Këshillin se citojmë “nuk ekziston ndonjë kërkesë e ankuesit e parashtruar lidhur me ngitje të koeficientit”

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës nga koeficienti pesë (5) në koeficientin gjashtë (6), edhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi

ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase, sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedhë se ankuesi me datë 07.03.2013 ka nënshkruar pa vërejtje aktin e emërimit për pozitën e punës *Asistent Administrativ* me koeficient të pagës pesë (5), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës, nuk ka ndër marr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri në ankesën e datës 14.07.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 07.03.2013), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: *130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.*

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.Nr.639/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Proçesmbajtëse

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

